

AKT-THEMELIMI I SHOQERISE "BORESAL" SH.P.K

Në Tiranë sot më date 25.03.2022, une i nenshkruari :

Z_ **Boris Allmuça**, i datelindjes 20.10.1995 lindur ne Tirane dhe banues ne rr"Endri Keko", Tirane me nr. ID J51020074N .me cilësinë e ortakut te vetem themelues;

Mbeshtetur në Ligjin 9901 datë 14. 04. 2008, "Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare", Ligjin Nr. 9723 date 03. 05. 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", krijon shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, te emertuar: "**BORESAL**" sh. p. k.

KREU I

NENI 1

KRIJIMI

Shoqëria "BORESAL" sh.p.k. është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur Shoqëria).

NENI 2

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet e procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkatuara gjatë veprimtarisë së saj.

Kapitali i Shoqerisë ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetëm, që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

NENI 3

SELIA

Shoqëria e ka selinë në adresën Rr"Endri Keko"pallatet "Xheker", Tirane.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hape zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

- Investime ne fushen e magazinave bujqesore.
- Mbareshtim dhe rritje shpendesh, apo kafshesh.
- Tregti ne fusha dhe produkte te ndryshme si kafshe apo ushqime.
- Investime ne fushen e pijeve ne menyre artizanale dhe tregtimi i tyre.



- Investime ne fushen e Bujqesise dhe sektore te ndryshem.
- Investime ne fushen e agroturizmit, kantina, hotelerise, bare dhe restorante etj.
- Si dhe cdo veprimtari tjetër e pashkruar ne kete statut por qe me vendim te asamblese, mund te jete objekt i veprimtarise se kesaj shoqerie.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

KREU II KAPITALI NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i perbere nga 1 kuote. Kapitali eshte i zoteruar 100% nga ortaku i vetem z. **Boris Allmuça**.

Kapitali i mësipërm është i nënshkruar teresisht nga ortaku i vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërise përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë:

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te Vetem.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve.

Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANI VENDIMMARRES

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj.


Ortaku u vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratori.

NENI 9

NDRYSHIMET E STATUTIT

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i Vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.



NENI 10

ADMINISTRIMI

Administrator i shoqerise eshte emeruar z. **Boris Allmuça**.

Administratori ushtron funksionin e tij per nje periudhe kohe 5 vjecare qe nga momenti i emerimit, me te drejte riemerimi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

NENI 11

KOMPETENCAT

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave, qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve, qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin, qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Administratorit nuk i lejohet te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj per paradhenie si dhe te behen dorezenes ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Klauzolat e ketij statusi, qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.

NENI 12

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 01 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 13

SHPERNDARJA, PRISHJA E SHOQERISE

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar sic mund te jene:

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimet te metejshem te veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

Kur plotesohet afati i caktuar per ushtimin e veprimtarise tregtare.

Me vendim te ortakut te Vetem.

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne te cilen parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 (nje) apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likujdim".

NENI 14

BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjore ne fuqi dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.



NENI 15

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem themelues, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM

BORIS ALLMUÇA

Boris Allmuça
